



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

**Nr. 19**

**Datë: 16. 06. 2023. Ora: 11:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

#### **1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

-Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr.18/2023

#### **2. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësim të anëtarëve të kuvendit komunal në Zveçan

-Shqyrtimi dhe miratimi i draft Rregullores për procedurën e zëvendësimit të anëtarëve të kuvendit komunal

- **Komiteti i Auditimit**

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

### 3. Të ndryshme

---

#### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

**Kreshnik Radoniqi:** Kryetari Radoniqi, fillimisht paraqiti agjendën. Ndërsa, lidhur me rendin e ditës, z. Sami Kurteshi tha shpjegoi se draft – rregullorja për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendit komunal, ende nuk ka mundur të përfundohet dhe ai propozoi që kjo të hiqet nga rendi i ditës. Kur të kryhet, të sillet në rend dite. Ndërsa, ai tha se ka edhe një njoftim tjetër nga agjenda e Komitetit të Auditimit.

Me dhjetë vota për, ( mungoi anëtari Rifat Krasniq), u miratua rendi i ditës, me heqjen e pikës së propozuar nga z. Kurteshi, dhe me një pikë të re te Komiteti i Auditimit.

Po ashtu, u miratua edhe procesverbali i mbledhjes nr. 18/2023.

#### 2. Raportet e Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësim të anëtarëve të kuvendit komunal në Zveçan

**Sami Hamiti:** Në këshill, ne kemi shqyrtuar tri kërkesa për zëvendësim të anëtarëve të kuvendit komunal në Zveçan. Janë plotësuar kushtet, dhe ne si këshill rekomandojmë për zëvendësim.

**Kreshnik Radoniqi:** Sipas rekomandimit, Izet Peci, zëvendësohet nga Jakup Peci nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”.

Me dhjetë vota për, miratohet ky zëvendësim.

**Kreshnik Radoniqi:** Po ashtu, Ilir Peci zëvendësohet nga Ukshin Peci nga subjekti politik PDK.

Me dhjetë vota për, miratohet ky zëvendësim.

**Kreshnik Radoniqi:** Po ashtu në Zveçan, Diellza Peci zëvendësohet nga Jehona Kelmendi nga subjekti politik PDK.

Me dhjetë vota për, miratohet ky zëvendësim.

**Ilir Gashi**, tha se është mirë që qysh sot, të njoftohet kuvendi komunal për këto zëvendësimë...

### **3. Komiteti i Auditimit**

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit:

**Sami Kurteshi**, kryesues i Komitetit të Auditimit të KQZ-së, tha se komiteti ka mbajtur takimin dhe ka shqyrtuar disa pika. Ju e keni marrë raportin. Mes tyre, raportin e zyrës kombëtare të auditimit. Ne i kemi trajtuar edhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA. Janë dy vërejtje – rekomandime. Ne kemi shqyrtuar edhe zbatimin e 25 rekomandimeve. I kemi shqyrtuar. Sekretariati i ka pa, ashtu pajtuar me të gjeturat. Kanë bërë edhe planin e veprimit, është dërguar...janë dy rekomandime që duhet të përmirësohen...Është kronologjia, janë afatet...

Komiteti i Auditimit e ka pranuar këtë plan, dhe rekomandimet duhet të zbatohen...

**Alban Krasniqi**, tha se ne nuk e kemi pranuar planin e auditimit. E kemi vetëm planin e zbatimit të rekomandimeve. Në ndërkohë, të na dërgohet raporti i Auditorit, ta shohim, ta trajtojmë dhe më pastaj, nëse ne kemi të shtojmë...

Nuk e kemi raportin, së pari ta kemi raportin...

**Sami Krasniqi**: Pajtohem me Albanin, duhet të na dërgohet...Është mirë që anëtarët ta kemi. Raportet e ZKA nuk ja qëllonjë, por “opinion i pakualifikuar”, është më i miri...Nuk e kemi as të parin as tjetrin, dhe tash të tretin...nuk e kemi mirë...

Është dashur të na dërgohet, opinionin me të gjeturat dallon...! S’ka keqpërdorim, por ka neglizhim! Të na dërgohet, të shohim dhe planin e rekomandimeve, zbatimin dhe pastaj ua dërgojmë edhe institucioneve tjera...

Në këtë pikë, foli edhe **Ibrahim Selmanaj**, anëtarë i KA-së, dhe tha se të evitohen neglizhimet se nuk ka shkelje, dhe se ana profesionale nuk mundon, por ka pak vonesa, dhe se të rritet komunikimi i brendshëm...

**Sami Kurteshi**, tha se po, le të analizohet, të shihet raporti dhe tek pastaj të miratohet...

Tani po kaloj në temën tjetër, ka qenë mbledhja e tretë. Kemi diskutuar dhe analizuar edhe raportin e brendshëm të Auditimit, me kërkesë të kryesuesit të KQZ-së, kjo në lidhje me rekrutimet e fundit. Auditori e ka sjellë një raport. Ka të gjetura. Me shumicë votash, nuk është miratuar raporti dhe është kërkuar një ekstra – raport auditues... Pra, kërkohet një auditim tjetër, nga një auditor tjetër...

**Sami Hamiti**, tha se auditim i ri nuk duhet të bëhet, por në rregull, “cilësohet” shkon atje te njësia e auditimit të brendshëm në MEF...

Unë pajtohem të shkoj në vlerësim, ligji e kërkon...

**Sami Kurteshi**: Kjo është bërë me kërkesën e anëtarëve, edhe të auditorit... Megjithëse, unë kam votue për miratim...

**Ibrahim Selmanaj**, tha se vërejtjet janë në pjesë të raportit, në parim është pranue. Raporti e ka efektin e vet...

Në këtë pikë, foli edhe **Alban Krasniqi**, i cili pati vërejtjet rreth kësaj pike. Edhe njëherë, ai kërkoi që raporti i auditorit t’u shpërndahet anëtarëve të KQZ. Ta shohim ne, ta trajtojmë... Bile, edhe anëtarët e Këshillit Personel ta kenë...

Ka probleme rreth procesit të rekrutimit... Po dëmtohet integriteti i institucionit, prandaj duhet të respektohen standardet, të mënjanoen manipulimet në procesin e rekrutimit... Secili, ta merr përgjegjësinë...

Ju njoftoj, tha z. Krasniqi, veq e kemi filluar si grup punues me nxjerrjen e akteve të reja. Jemi duke e shqyrtuar mundësinë e sigurimit të një eksperti... Prandaj, dokumenti të shpërndahet, dhe të shkoj te njësia përkatëse...Kemi procese të hapura...

**Sami Hamiti**: Procedura e rekrutimit është pjesë që ndërlidhet me Sekretariatit. Ne, se ndalim, janë procedurat e ndara, janë institucionet tjera...

Po flas profesionalisht, auditimi është dashtë të bëhet kur të kryhet procesi. Se, janë instancat e tjera që e shqyrtojnë procesin e rekrutimit, e përcaktojnë... Këto nuk janë çështje tona: nuk vendosim as ne, as auditimi...

Alban Krasniqi: Roli i auditimit, është me parandalu. Kur të kryhet procesi, nuk bëhet...Ky raport, është si me përmirësua raportin, por nuk mund të injorohen kërkesat e brendshme, pra sidomos të auditorit...Me u përmirësue, qoftë duke e ndalë një proces, qoftë për me e përmirësue...

Pra, me i parandalu të metat gjatë procesit. Të gjeturat duhet të emërtohen...

**Kreshnik Radoniqi**: Unë, e kam kërkuar raportin, sepse janë shfaqur shumë dyshime në proces. Unë, me e thirrë policinë, është procedurë tjetër, por për një është kërkuar policia, por për dy raste tjera, unë kam kërkuar auditim...

Është e drejtë e imja. Me i lënë në heshtje disa veprime që po shfaqen, e që janë shkelje procedurale, unë se di se a janë të vërteta por që janë shkelje procedurale që po shfaqen, unë s'mundem me i lejue...!

**Sami Kurteshi**: anëtarëve tu shpërndahen materialet, raportet... U kërkuar që raporti të shkoj në rivlerësim...

Një gjë, ju e keni pa që ka dalë edhe në media se, është pranuar gruaja e policit në punë, i cili i ka ba hetimet për rastin e "dezinfektuesve", e të cilin rast prokuroria e ka kthye si të pabazuara... Unë, meqë e kam ngritë këtë rast, e ftojë prokurorinë që para nesh ta shohim edhe njëherë se si ka qenë kjo punë...

#### **4. Të ndryshme**

**Burim Ahmetaj**: E kemi dërguar një imell mbi aktin final nga grupi final për Strategjinë. Ky dokument, ishte mirë që të vendoset se kur mund ta shqyrtojmë për herë të fundit...?

U vendos që, në mbledhjen e radhës të shihet edhe njëherë Strategjia...dhe, varësisht nga çështjet të vendoset...